

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, A.H., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1 të KPK, dhe Zh.K., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të fituar me kryerjen veprës penale nga neni 345 par 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.H., av. I.G., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.87/2017, të datës 08.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.H., av. I.G., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.87/2017, të datës 08.03.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Mitrovicë, P.nr.87/2017, të datës 08.03.2017, janë shpallur fajtor të akuzuarit:

- A.H., dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.16.01.2017 deri me dt. 01.03.2017, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej në afat prej 2 (dy) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 €, dhe

- Zh.K., për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të fituar me kryerjen veprës penale nga neni 345 par 2 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 20 (njëzetë) €, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo-juridik.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. I.G., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit A.H., ti shqiptohet dënimi më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.422/2017, të datës 05.04.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka caktuar seancën e kolegjit, për të cilën i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancën e kolegjit ka prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av.I.G., kurse palët tjera nuk kanë qenë prezent, për kundër asaj që njoftimet i kanë pranuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, andaj, kolegji i kësaj gjykate ka vazhduar me seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.H., av. I.G., nuk është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarve, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohehet për shkak vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, mirëpo me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat për zbutjen e dënimit, si dhe rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, e sidomos ato lehtësuese, sikurse janë, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka bashkëpunuar me policinë dhe gjykatën, se është i moshës së re, se është penduar për veprën penale të kryer, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin, se është i gjendjes së dobët ekonomike, se është i pa martuar, i pa punë, se nuk dinë shkrim-lexim, dhe se ky dënim nuk është proporcional me peshën e veprës penale të kryer, andaj, konsiderojmë se dënimi i shqiptuar është tejet i lartë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në

përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka shprehur keqardhje për veprën penale të kryer, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është proporcional me peshën e veprës penale të kryer, dhe është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.399/2017 të datës 22.05.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq